



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**  
**SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Patos, më 19/05/2026

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**Bazë materiale për përmirësimin e rrjetit kullues dhe vaditës**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Materiale ndërtimi dhe produkte të ngjashme 44100000-1

Tuba kullimi 44163110-4

**VLERA E FONDIT LIMIT: 3,141,342 (tre milion e njëqind e dyzet e një mijë e treqind e dyzet e dy) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga të ardhurat lokale për vitin 2026, për objektin: “Bazë materiale për përmirësimin e rrjetit kullues dhe vaditës”.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Patos** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

## 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatori ekonomik duhet të paraqes xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare 2023, 2024, 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra vlerën e 40% te fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2 Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor kështu e maturuara për vitin 2026, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2026.

*(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).*

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

*Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2025 prane bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, vetëm njërin prej llojeve të dokumentave të përcaktuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se ... % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

**3,141,342 x 40% = 1,256,536.8 Lekë.**

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të vetdeklaroj se merr përsipër furnizimin (dorëzimin ngarkimin dhe shkarkimin) e mallit objekt prokurimi me kostot e veta, të cilat do të dorëzohen në magazinën e Bashkisë Patos në prani të komisionit të ngritur për marrje në dorëzim, sipas

nevojave të autoritetit kontraktor. Operatori ekonomik fitues duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor 24 orë para dorëzimit të mallit. Baza materiale e kërkuar duhet të jetë në përputhje me zërat në preventiv, të cilat do të shoqërohen me dokumentacionin përkatës që vërteton sasinë dhe cilësinë e materialit. Çdo material do të vlerohet dhe miratohet para marrjes në dorëzim nga komisioni i ngritur me urdhër të titullarit.

**ARGUMENTIM:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 8 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky vetdeklarim kërkohet për të vërtetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përpara i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

**2.3.3.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë në pronësi ose me qera, mjetet e mëposhtme:

- Mjet vetshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton copë 2
- Kamion me vinç copë 1

---

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose qera (me kontratë noteriale), duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtem:

- lejen e qarkullimit.
- certifikatat e pronësisë, në rastin kur është aplikuar.
- siguracionin e mjetit,
- kolaudimin,
- certifikatë transporti
- fotografi të mjetit të paraqitura. (të cilat duhet të jenë në emër të shoqërisë ose në emër të qeradhënësit).

Për mjetet dhe pajisjet të cilat nuk kanë leje qarkullimi, Ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratë noteriale të blerjes,
  - fatura tatimore të blerjes ose dokumenta zhdoganimit të mjetit.
- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit,(të vlefshme), të shoqëruar me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit noteriale,, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikës 5/ç nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Këto mjete janë kërkuar nisur nga sasia e konsidueshme e mallrave objekt prokurimi, vendodhjet e ndryshme të objekteve ku do të vendosen materialet.

**2.3.4.** Operatori ekonomik duhet të paraqesi autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit si: telefon, fax, email, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Për materialet si :

Nr.	Nr. Analize	Emërtimi i materialeve	Njësia	Sasia
1	3.363	Tuba betoni Φ400mm	ml	1
2	3.365	Tuba betoni Φ600mm	ml	1
3	3.366	Tuba betoni Φ800mm	ml	1
4	3.369	Tuba betoni Φ1500mm	ml	1

Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit si dhe skedën teknike për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe specifikohen qartë materialet që do të ofrohen, në rastin kur janë në gjuhë të huaj ato duhet të përkthehen dhe noterizohen në gjuhën shqipe.

**ARGUMENTIM:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 5/a dhe pika 8, të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar.

**2.3.5.** Operatorët ekonomik pjesmarrës në procedurën e prokurimit duhet të dorëzojnë në ambjentet e magazinës pranë Bashkisë Patos në datën 01/06/2026 deri në orën 09:00, (para hapjes së fazës së vlerësimit nga KVO përkatëse) mostrat për zërat si më poshtë minimalisht me gjatësi 1 (një) ml për tubot dhe nga 1 (një) copë për materialet e tjera :

Nr.	Nr. Analize	Emërtimi i materialeve	Njësia	Sasia
1	3.363	Tuba betoni Φ400mm	ml	1
2	3.365	Tuba betoni Φ600mm	ml	1
3	3.366	Tuba betoni Φ800mm	ml	1
4	3.369	Tuba betoni Φ1500mm	ml	1

Ky kriter i shërben Autoritetit Kontraktor për rëndësinë dhe cilësinë e këtij produkti ndaj është e nevojshme sjellja e mostrave.

**Shënim:** Ky kriter përbën kusht skualifikimi në rast se mostrat e dorëzuara nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Mosparaqitja mostrave përbën kusht për skualifikim.

Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken 6 gërma a, të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: *6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 39 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.*

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Skicimet, parametrat teknik etj:

- **Tuba betoni Ø400mm**

Përmasat gjeometrike:

1. Diametri i brendshëm (DN): 400mm
2. Diametri i jashtëm: 600 mm (me trashësi muri 100mm)
3. Trashësia e murit: 100 mm
4. Gjatësia: 1.0 m

- Klasa e betonit do të jetë C20/25 me armaturë zgarë Ø6mm.
- Lidhja e materialit (pika e takimit të dy tombinove) të bëhet me llaç-çimentoje.
- Sipërfaqja e brendshme duhet të jetë e lëmuar, me koeficient të ulët fërkimi.
- Materiali nuk duhet të ketë çarje strukturore, apo dëmtime në pikat e takimit të dy tombinove.
- Pesha për 1 tombino varion nga 300-450 kg/copë.

Materiali duhet të plotësojë kushtet sipas standarteve të përdorimit në infrastrukturën e kanalizimeve në përputhje me EN 1916/EN1610.

- **Tuba betoni Ø600mm**

Përmasat gjeometrike:

1. Diametri i brendshëm (DN): 600mm
2. Diametri i jashtëm: 800 mm (me trashësi muri 100mm)
3. Trashësia e murit: 100 mm
4. Gjatësia: 1.0 m

- Klasa e betonit do të jetë C20/25 me armaturë zgarë Ø6mm.
- Lidhja e materialit (pika e takimit të dy tombinove) të bëhet me llaç-çimentoje.
- Sipërfaqja e brendshme duhet të jetë e lëmuar, me koeficient të ulët fërkimi.
- Materiali nuk duhet të ketë çarje strukturore, apo dëmtime në pikat e takimit të dy tombinove.
- Pesha për 1 tombino varion nga 520-550 kg/copë.

Materiali duhet të plotësojë kushtet sipas standarteve të përdorimit në infrastrukturën e kanalizimeve në përputhje me EN 1916/EN1610.

- **Tuba betoni Ø800mm**

Përmasat gjeometrike:

1. Diametri i brendshëm (DN): 800mm
2. Diametri i jashtëm: 1000 mm (me trashësi muri 100mm)
3. Trashësia e murit: 100 mm
4. Gjatësia: 1.0 m

- Klasa e betonit do të jetë C20/25 me armaturë zgarë Ø6mm.
- Lidhja e materialit (pika e takimit të dy tombinove) të bëhet me llaç-çimentoje.
- Sipërfaqja e brendshme duhet të jetë e lëmuar, me koeficient të ulët fërkimi.
- Materiali nuk duhet të ketë çarje strukturore, apo dëmtime në pikat e takimit të dy tombinove.
- Pesha për 1 tombino varion nga 670-700 kg/copë.

Materiali duhet të plotësojë kushtet sipas standarteve të përdorimit në infrastrukturën e kanalizimeve në përputhje me EN 1916/EN1610.

- **Tuba betoni Ø1500mm**

Përmasat gjeometrike:

1. Diametri i brendshëm (DN): 1500mm
2. Diametri i jashtëm: 1700 mm (me trashësi muri 100mm)
3. Trashësia e murit: 100 mm
4. Gjatësia: 1.0 m

- Klasa e betonit do të jetë C20/25 me armaturë zgarë Ø6mm.
- Lidhja e materialit (pika e takimit të dy tombinove) të bëhet me llaç-çimentoje.
- Sipërfaqja e brendshme duhet të jetë e lëmuar, me koeficient të ulët fërkimi.
- Materiali nuk duhet të ketë çarje strukturore, apo dëmtime në pikat e takimit të dy tombinove.
- Peshë për 1 tombino varion nga 1200-1250 kg/copë.

Materiali duhet të plotësojë kushtet sipas standarteve të përdorimit në infrastrukturën e kanalizimeve në përputhje me EN 1916/EN1610.

- **Çakëll (Granil për betone)**

- Material i thyer, i pastër, pa materiale organike, baltë apo argjilë.
- Fraksioni i lejuar është deri në 20mm. Forma e kokrrës duhet të jetë këndore ose poligoniale, e thyer.
- Treguesi i Los Angeles (rezistenca ndaj konsumit) jo më i madhe se 25.
- Rezistenca në shtypje jo më pak se 800kg/cm<sup>2</sup>.

Materiali duhet të plotësojë kërkesat e STASH 539-87 “Për punime ndërtimi”.

- **Çimento 32.5N**

Çimento 32.5N duhet të jetë në përputhje me EN 206-1 dhe EN 197-1. Çimento Portland me shtesa gëlqërore CEM II/B-LL, sipas EN 197-1. Të jetë e ambalazhuar për t’ju rezistuar kushteve të magazinimit në ambiente ku përqindja e lagështirës është e lartë. Kollitë të jenë me paleta druri dhe të mbështjella me plastmas.

- **Rërë e larë (inerte të imta)**

Inertet e imta konform STASH 512-78 do të jenë prej rëre natyrale, gur të shoshitur. Inertet e imta të marra nga gur të shoshitur duhet të jenë të mprehtë, kubikë, të fortë. Inertet e imta duhet të jenë në një cilësi shumë të mirë nga rëra e brigjeve. Ajo duhet të jetë e pastruar nga materialet natyrale e klasifikuar nga më e holla deri tek më e trasha, pa copëza nga argjila, rëra, plehra apo cifla të tjera. Nuk duhet të përmbajë më shumë se 10 % të materialit më të hollë se 0.10 mm të hapësirës në rrjetë, i gjithë materiali duhet të kalojë në një rrjetë 10mm.

- **Zgarë hekuri Ø6**

Zgara e përbërë me shufra Ø6 do të vendosen me hap 15 cm në të dyja drejtimet do të përdoret si armaturë e shpërndarë për shkak të ngarkesave jo shumë të mëdha. Lidhja e shufrave është e fabrikuar. Rrjeti standart është 15x15cm me përmasa 5x2m.

**Shënim:** Baza materiale do të dorëzohet nga operatori me dokumentacionin teknik përkatës sipas specifikimeve teknike të kërkuara.

Specifikimet teknike u hartuan nga **Drejtoria e Zhvillimit të Territorit dhe Emergjencave Civile** duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e nenit 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, e nenit 40 pika 2, si edhe të Nenit 44 “Kerkesat e cilesise” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimitisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **01/06/2026, ora 09:00**.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me **objekt “Bazë materiale për përmirësimin e rrjetit kullues dhe vaditës”**.

Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

**Bashkëlidhur këtij procesverbali:**

Dokumentat e tenderit.

#### **NJESIA E PROKURIMIT**

Imela Halimi

Boreta Murati

Florian Kita